



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2023:185370

Datë: 28.12.2023

Numri i dokumentit: 05133846

PPP.nr. 22A/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Freskim Musliu, në çështjen përbarimore të kreditorit Telekom i Kosovës sh.a., me seli në Prishtinë, kundër debitorit A . M . nga Komuna e Fushë Kosovës, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.333/23, të datës 13.07.2023, të lejuar nga Përbaruesi Privat A . B . nga Prishtina, jashtë seancës, me datë 28.12.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit A . M . nga Komuna e Fushë Kosovës ashtu që ANULOHET Urdhri Përbarimor P.nr.333/23, i datës 13.07.2023, i lejuar nga Përbaruesi Privat A . B . nga Prishtina.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrin Përbarimor P.nr.333/23, të datës 13.07.2023, me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht faturës nr. . . . , të datës 05.03.2023, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që kreditorit t’ia paguajë shumën prej 36.17 euro, si dhe shpenzimet e përbarimit.

Debitori ka parashtruar prapësim brenda afatit ligjor duke kundërshtuar në tërësi urdhrin përbarimor me arsyetimin se dokumentet e bashkangjitura propozimit për përbarim nuk e kanë cilësinë e dokumentit të besueshëm sikurse është paraparë me nenin 38 të LPP-së dhe se fatura kontestuese nuk është bashkangjitur në origjinal apo kopje të vërtetuar, e po ashtu ka cekur faktin se kreditori nuk i ka sjellë debitorit faturim të rregullt. Ka kërkuar që të aprovet si i bazuar prapësimi i tij dhe të anulohet urdhri përbarimor i lartcekur.

Kreditori nuk ka paraqitur fare përgjigje në prapësim.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar

dispozitive të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbaremore, (LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar.

Sipas nenit 29 parag. 1 të LPP-së, përcaktohet se “*Përmbaremi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*”, ndërsa me nënparg. 1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 parag. 3 të LPP-së, përcaktohet se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbaremi po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “*Kur propozimi për përmbaremi paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*”.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se fatura nr. 221014105121/2252, e datës 05.03.2023 nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se e njëjta nuk përmban nënshkrimin e debitorit, andaj nuk mund të vërtetohet se fatura është pranuar në mënyrë të rregullt nga ana debitorit. Në anën tjetër, kreditori nuk ka bashkëngjitur asnjë provë nga e cila dëshmohet se fatura është dorëzuar në ndonjë formë tjetër tek debitori, ashtu që ky i fundit e ka pranuar faturën dhe është njoftuar lidhur me detyrimin që rrjedh nga fatura e tillë.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se dokumenti mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbaremi, e mbi bazën e të cilit përmbaremi privat ka lejuar përmbaremin, nuk ka tipare të përmbaremeshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaremit duhet të anulohet.

Andaj, në kuptim të nenit 71 parag. 1.1 dhe 73 të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

PPP.nr.22A/23, me datë 28.12.2023.

Gjyqtari

Freskim Musliu

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.